



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I QARKUT KORÇË

### VENDIM

Nr. 33, dt. 13.09.2024

#### **MBI MIRATIMIN E SHTIMIT NË BUXHET DHE PËRDORIMIT TË FONDIT TË ARDHUR NGA BE, NËPËRMJET BANKËS TË SHQIPËRISË, PËR RIMBURSIMIN E SHPENZIMEVE TË PROJEKTIT SAVE ËATER**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar Ligjit "Për buxhetin e vitit 2024", Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2024, si dhe udhëzimit nr.35 dt.31.09.2020 "Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

### VENDOSI

1. Të miratojë përdorimin e fondit të ardhur për rimbursimin e shpenzimeve të kryera për projektin e huaj SAVE WATER, prej 2372478.72 lekë,
2. Të miratojë shtesë në buxhetin e Këshillit të Qarkut për vitin 2024 të fondit të sipërcituar në vlerë 2372478.72 lekë.
3. Fondi prej 2372478.72 lekë do të përdoret për investimin me objekt ndërtimi i Muzeut Dritëro Agolli, sipas strukturës buxhetore të mëposhtme:

00/04130/05/231                      2372478.72 lekë (Ndërtimi i Muzeut Dritëro Agolli)

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i financës, zhvillimit ekonomik, shërbimeve, burimeve njerezore dhe zhvillimit të territorit, të gjithë zyrtarët e administratës së Këshillit të Qarkut, Dega e Thesarit.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti

**KRYETARI**  
**Erjon Nexhipi**

Miruar me                      / 14 / Vota  
Vota Pro                        / 14 /  
Vota Kundër                    / 0 /  
Vota Abstënim                / 0 /  
Zbardhur më datë            / 13/09/2024

Konceptçi O. Beqiraj  
Juristi M.Bylykbashi  
Sek. K. Qarkut B. Muço





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

*RELACION*

**MBI MIRATIMIN E SHTIMIT NË BUXHET DHE PËRDORIMIT TË FONDIT  
TË ARDHUR NGA BE, NËPËRMJET BANKËS TË SHQIPËRISË, PËR  
RIMBURSIMIN E SHPENZIMEVE TË PROJEKTIT SAVE WATER**

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar Ligjit “Për buxhetin e vitit 2024”, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2024, udhëzimit nr.35 dt.31.09.2020 “Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare”, si dhe bazuar në komunikimet shkresore me Ministrinë e Financave në lidhje me fondet që na vijnë nga projektet me financim të huaj që ka zbatuar Këshilli i Qarkut, për rimbursimin e shpenzimeve të kryera, ju paraqesim për miratim shtimin në buxhet dhe përdorimin e fondit të ardhur nga BE-ja, nëpërmjet bankës të shqipërisë, për rimbursimin e shpenzimeve të kryera nga Këshilli i Qarkut, për projektin Save Water.

Këshilli i Qarkut Korçë ka zbatuar 5 projekte të financuara me fondet e Bashkimit Europian. Si pjesë e zbatimit të tyre, institucioni ka planifikuar në buxhetin e saj gjatë gjithë kësaj periudhe, fonde për bashkëfinancimet dhe parafinancimet, sipas legjislacionit në fuqi. Duke qënë se donatori(BE) bën disbursimet pas verifikimit të shpenzimeve dhe aktiviteteve të kryera, lind nevojca e parafinancimit me vetë fondet e institucionit.

Konkretisht projekti SAVE WATER ka përfunduar, pra nuk ka më aktivitete për tu realizuar, ndërkohë që ashtu si edhe për projektet e tjera nuk ka përfunduar disbursimi i të gjitha fondeve nga donatori.

Disbursimi i fundit që është bërë nga donatori në llogarinë speciale të Bankës të Shqipërisë për projektin SAVE WATER, është 23649.11 euro, vlerë kjo e cila kaloi nga llogaria speciale e projektit SAVE WATER në BSH, në llogarinë tonë në thesar duke u konvertuar në 2372478.72 lekë, për rimbursimin e shpenzimeve të kryera paraprakisht nga fondet tona buxhetore për këtë projekt.

Ky fond do ti bashkohet buxhetit të vitit 2024 sipas strukturës më poshtë:

00/04130/05/231

2372478.72 lekë (Ndërtimi i Muzeut Dritëro Agolli)

Me vendimin nr.14 dt.15.03.2024, Këshilli I Qarkut miratoi investimin për Muzeun Dritëro Agolli në Bashkinë Devoll. Preventivi I ridërguar nga Bashkia Devoll në lidhje me këtë investim ka një vlerë më të madhe sesa ajo e miratuar me vendimin nr.14 dt.15.03.2024. Duke qënë se ky është një investim me një impact mjaft të madh për Qarkun tonë në tërësi, Këshilli I Qarkut mer për sipër të shtojë fondin për ndërtimin e Muzeut Dritëro Agolli, sipas preventivit të dorëzuar nga Bashkia Devoll. Në këto kushte, i propozojmë Këshillit të miratojë fondin e mësipërm për tu përdorur për ndërtimin e Muzeut Dritëro Agolli, Devoll.

Korçë me 23.08.2024

Oljona Beqiraj  
Përgjegjëse e Financës

